




NE



VENDOSIM

## QEVERISJA E POPULLIT

AURELA (14), ADONIS (14), RINA (13)



**Ne, nxënësit e klasës VIII-1 kemi përgatitur një artikull për qeverisjen e popullit, e cila është demokracia. Ne ju ftojmë që ta lexoni këtë artikull, pasi që do t'iu japim më shumë informata rreth saj**

Sot kemi ardhur në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti„. Pas disa aktiviteteve të ndryshme, ne u bëmë gazetarë. Më vonë, ne vazhduam me mësim dhe informata rreth demokracisë. A dëshironi edhe ju të mësoni çfarë mësuam ne? Atëherë vazhoni leximin...

Fjala demokraci rrjedh nga gjuha e lashtë greke. Fjala „demos„ do të thotë popull dhe fjala „kratos“ do të thotë qeverisje. Nga kjo kuptojmë se demokracia është qeverisje e popullit. Vendlindja e demokracisë konsiderohet të jetë Greqia, më saktë Athina, kryeqyteti i saj. Ndërsa, datëlindja e demokracisë është viti 507 para erës sonë. Në atë kohë, demokracia ishte demokraci direkte, apo demokraci e drejtpërdrejtë. Në këtë formë të demokracisë ka pasur rregulla të shumta si: gratë, të varfërit, të moshuarit, e as personat nën moshën 18 vjeçare nuk lejoheshin të merrnin pjesë në vendimmarrje. Të vetmit që lejoheshin ishin burrat e

pasur dhe banorët vendas. Kjo nuk ishte demokraci e plotë, ku për dallim nga atëherë, sot nuk janë këto rregulla në demokracinë direkte. Prandaj, me kohën, duke u zhvilluar vendet e botës, edhe demokracia ndryshoi. Ndryshimet që u bënë ishin pozitive. Kështu lindi forma e dytë e demokracisë, e cila u quajt demokraci përfaqësuese. Ajo do të thotë se qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e tyre me anë të votave, pastaj ata në emër të popullit marrin vendime për të gjithë.

Për ta kuptuar më lehtë, ne po marrim një shembull: ne votojmë për kryetarin\en e klasës, pastaj ai\ajo na përfaqëson në mbledhje të Këshillit të nxënësve të shkollës sonë. Ne gjithmonë votojmë për atë kandidat, i/e cili/a na duket më i\e përshtatshëm\e.

Faleminderit që na kushtuat kohën tuaj duke lexuar punën tonë dhe shpresojmë që keni mësuar po aq sa edhe ne mbi temën e demokracisë.




Kështu duken gazetarët e mirëfilltë



Gazetarët që shkruajtën këtë artikull

## ZGJEDHJA, E DREJTA JOTE

ANITA (14), BLEONA (14), ELKETA (14), FLORENT (13), GENTRIT (13), FITIM (13)



### Nëse ne si klasë duhet të marrim një vendim së bashku, si ia bëjmë? Vazhdoni të lexoni për ta kuptuar

Të zgjedhësh do të thotë të përcaktohesh. Ky përcaktim shpesh e vulos të ardhmen. Nganjëherë, zgjedhjet që bëjmë e prekin vetëm jetën tonë. Marrim shembull, kur zgjedhim një rrobë të caktuar. Nëse zgjedhim dhe më vonë e shohim se nuk është duke na pëlqyer, nuk e përdorim më atë. Pra, me këtë zgjedhje nuk e dëmtojmë askënd. Mirëpo, ka raste kur zgjedhjet tona prekin edhe jetën e dikujt tjetër. Një ndër këto raste është procesi zgjedhor.

Në këtë proces që i përfshin të gjithë qytetarët e vendeve demokratike, pa dyshim se preken edhe jetërat e tyre. Gjatë këtij procesi, qytetarët zgjedhin personat, të cilët do të udhëheqin vendin e tyre. Mënyra se si udhëhiqet një vend, ndikon tek të gjithë qytetarët e atij vendi. Prandaj, vendimi ynë dhe zgjedhja jonë duhet të jenë të matura, sepse ndikojnë tek të gjithë. Kjo është arsyeja, pse themi se procesi zgjedhor është procesi më i rëndësishëm demokratik. Po ashtu, kjo është edhe një ndër arsyet kryesore pse ekziston rregulli që thotë se duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare, për të marrë pjesë në këtë proces. Nga kjo kuptojmë se duhet të jemi të pjekur, të vetëdijshëm dhe të pavarur në vendimin që e marrim, për t'ia besuar votën dikujt. Ndonëse kemi zgjedhur dhe kemi votuar në shtëpitë tona, në klasën tonë, me shokët dhe shoqet, ne as-

njëherë nuk kemi menduar se vota jonë është e drejta jonë. Sot e kuptuam se vërtet në demokraci, vota është një ndër të drejtat më të rëndësishme që i kemi. Ne në Kosovë i zgjedhim kryetarët e komunave përkatëse, bashkë me asambleistët e asaj komune. Këto zgjedhje ndryshe njihen si zgjedhje komunale apo lokale. Gjithashtu, ne i zgjedhim edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës. Këto zgjedhje njihen si zgjedhje qendrore apo parlamentare. Ndërkaq, Presidentin e vendit e zgjedhin pikërisht deputetët. Kjo është një lloj, sikurse grupet që i kemi këtu në Punëtorinë e Demokracisë. Ne këtu jemi tri grupe dhe nëse secili grup e cakton kryetarin e grupit, atëherë këta kryetarë mblidhen dhe zgjedhin kryetarin e Punëtorisë.

Të dashur lexues, mos e harroni se vota juaj është e drejta juaj. Kjo e drejtë duhet të shfrytëzohet, sepse ndikon tek e ardhmja e gjithë vendit. Bëhu pjesë e vendimarrjes me anë të votës.



Grupi „Kika“



# PUSHTETI I NDARË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

NORA (13), AID (14), SUELA (14), ALTIN (14), FJOLLA (13), DETJON (14)



## Lidhja mes ndarjes së pushtetit dhe punëve të kryesisë së klasës sonë

Ne nxënësit e klasës së VIII-të, duam të tregojmë se si funksionon klasa jonë. Ne jemi 18 nxënës dhe secili ka të drejtë të japë mendimin e tij për zgjedhjen e kryesisë së klasës sonë. Pë çdo vit e zgjedhim kryetarin, sekretarin dhe arkatarin e klasës.

Kryetari, sekretari dhe arkatari zgjedhen me pajtimin dhe votimin e klasës. Ai zakonisht merret me përfaqësimin e klasës, por nëse kemi ndonjë konflikt me njëritjetrin, kryetari e ka për detyrë t'i tregojë kujdestarit të klasës. Sekretari, në anën tjetër, i ndihmon kryetarin në punët e mbetura dhe në rast se kryetari nuk është i lirë apo është në ndonjë mbledhje, atëherë sekretari e zëvendëson atë. Kurse, arkatari i klasës ka për detyrë ta menaxhojë buxhetin e klasës. Të ardhurat që hyjnë në klasën tonë, vijnë nga mungesat tona. Nëse dikush mungon, atëherë mungesën ai duhet ta paguaj përmes

një shume të vogël parash. Ato para që ne i kursejmë, vendosim që t'i shfrytëzojmë për blerjen e një atlasit gjeografik apo ndonjë topi futbollit, ose mund t'i sigurojmë fanellat me të cilat e përfaqësojmë shkollën tonë në gara të ndryshme.

Një ndarje e fillë, si ajo e udhëheqësisë së klasës sonë ndodh edhe në Republikën e Kosovës. Sikurse në shtetet e tjera, edhe pushteti i qytetarëve të Kosovës duhet të menaxhohet siç duhet. Por, që të realizohet qëllimi i përcaktuar i shtetit tonë, pushteti ndahet në tri pjesë: në Pushtetin Legjislativ, Pushtetin Ekzekutiv dhe Pushtetin Gjyqësor. Pushteti Legjislativ ka për detyrë t'i vendos ligjet, në bazë të të cilëve rregullohet jefa e qytetarëve. Pushteti Ekzekutiv duhet të ekzekutojë të gjitha ligjet që miratohen në Kuvend. Ndërsa, Pushteti Gjyqësor ka për detyrë të merret me drejtësinë e shtetit. Të gjitha krimet që ndodhin brenda shtetit, gjykatat duhet t'i gjykojnë në mënyrën më të drejtë.



Autorët e artikullit



Vendi ku miratohen ligjet

# LËVIZJA E POPULLIT

VALDRIN (13), GENITA (13), ELTON (13)

**Grupi ynë ka diskutuar dhe punuar mbi çështjen e qytetarisë aktive. A dëshironi të mësoni më shumë për këtë temë? Atëherë lexojeni artikullin tonë**

Fillimisht ne mësuam për demokracinë. Me fjalën demokraci nënkuptojmë qeverisjen e popullit. Por, ju mund të pyesni, si mund të qeveris populli?


Ne mendojmë se demokracia na ofron shumë të drejta, që ndoshta qytetarët në shtetet që qeverisen në forma të tjera të qeverisjes, nuk i gëzojnë ato.

Disa prej tyre janë: e drejta e fjalës, e drejta e të shprehurit të lirë, e drejta e shkollimit, e drejta e votës, e drejta për organizim dhe pjesëmarrje në tubime publike, etj. Ne e dijmë se në Kosovë ka një numër të madh të banorëve. Ai numër është rreth 2 milionë banorë. Në përbërjen e tyre etnike, përveç shqiptarëve ka edhe komunitete jo shumicë. Ato janë: komuniteti serb, romë, ashkali, egjiptian, turk, boshnjak dhe ai goran. Por, meqenëse edhe ata jetojnë në një vend de-

mokratik siç është Kosova, gëzojnë të drejta të njëjta dhe të barabarta me shqiptarët dhe duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë. Nga këta qytetarë, ka disa qytetarë të cilët janë më aktivë se të tjerët. A dëshironi të dini se çfarë bëjnë ata, në mënyrë që të jeni edhe ju më aktivë?

Ata janë të rregullt në votime, organizojnë dhe marrin pjesë në tubime të ndryshme publike, të cilat patjetër duhet të jenë paqësore, nënshkruajnë peticione, votojnë në referendume të ndryshme, etj.

Këta janë qytetarë, të cilët ndihen përgjegjës për zhvillimin e demokracisë, dhe ata janë qytetarë si ne. Secili nga ne, është përgjegjës për zhvillimin e demokracisë, prandaj kjo është një arsye më shumë për të gjithë ne që të bëhemi qytetarë sa më aktivë.



Ambienti i papastër dëmton shëndetin



Ne kemi mësuar për qytetarinë aktive





Ndërsa kur kemi ambient të pastër jemi edhe më të lumtur



Edhe ti mund të bësh ndryshimin!





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
 REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
 REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
 Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
 Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
 TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
 Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Skënderbeu“  
 E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-1  
 Website: www.demos-ti.org Vendi: Hogosht, Kamenicë